

VENDIM

Nr.218, date 10.4.2003

PER KALIMIN NE ADMINISTRIM TE BASHKISE SE QYTETIT PERMET TE ISH-SHTEPISE SE USHTARAKEVE NE KETE QYTET

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 13 te ligjit nr.8743, date 22.2.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit" dhe te neneve 7 e 8, shkronjat "a" e "c" te ligjit nr.8744, date 22.2.2001 "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit te Mbrojtjes, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Bashkise se qytetit te Permetit t'i kaloje ne administrim ish-shtepia e ushtarakeve ne kete qytet, e cila i jepet Qendres Kulturore te ketij qyteti per ta perdorur si muze te arkeologjise, etnografise, kultures, arsimit dhe figurave te shquara te rrethit te Permetit.
2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes te beje dorezimin e kesaj prone te paluajtshme.
3. Bashkise se qytetit te Permetit i ndalohet te ndryshoje destinacionin e percaktuar ne kete vendim, ta tjetersoje ose ta jape ne perdorim te te tretet.
4. Ngarkohet bashkia e qytetit te Permetit te perballoje shpenzimet per mirembajtjen e prones se dhene ne administrim.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano